

## Analiza financiare DPS 2020 dhe parashikimi për 2021


Plani buxhetor i DPS në vite në përgjithësi ka qenë rreth 30,000,000 - 35,000,000 lekë, ndersa per vitin 2020 ishte planifikuar ne shumen 42,280,000 leke, dhe u realizua ne shumen 27,768,963 leke ose 66 %. Ky mosrealizim i dedikohet nga njera ane shumes me te madhe te alokuar per kete vit ne shpenzimet operative krahasaur me vitet e tjera, (me nje rritje te planit buxhetor me 9 milione leke, nga 4,500,000 leke ne 13,200,000 leke) dhe nga ana tjetere per shkak te situates se krijuar nga Covid 19, pasi shume shpenzime sidomos ato te udhetimeve per pjesemarrje ne konferenca dhe aktivitete te ndryshme nderkombetare te planifikuara per udhetim e dieta ne vitin 2020, nuk u realizuan.

Buxheti është planifikuar për të realizuar detyrat funksionale të institucionit i alokuar për paga 35%, sigurime 7 %, shpenzime operative 31%, pagesë të kuotave ndërkombëtare 30%, dhe investime kapitale 3 % (Tabela 2).

**Table 1 Realizimi i buxhetit 2020 ne total dhe sipas zerave**

Nr.	EMERTIMI	Buxheti Plan	Buxheti Fakt	Realizimi ne %
1	Paga	15,000,000	14,022,671	93 %
2	Sigurime	3,000,000	2,297,389	77 %
3	Korrente	13,200,000	2,250,714	17 %
4	Kuotat nderk	9,000,000	8,383,432	93 %
5	Investime	2,000,000	834,168	42 %
	<b>SHUMA</b>	<b>42,280,000</b>	<b>27,768,063</b>	<b>66 %</b>

Table 2




Realizmi sipas zerave te buxhetit paraqitet ne tabelen 1, nga ku konstatohet se realizimi me i madh eshte ne zerin e pagave dhe ne pagesen e kuotave nderkombetare me 93%, sigurimet me 77%. Kurse mosrealizimin me te madh e kemi ne shpenzime operative, e realizuar ne masen 17% per arsyet e permendura me lart si dhe investimet ne masen 42%.

Investimet jane perdorur kryesisht per godinen me rikonstrukcione te nevojshme pas transferimit ne keto ambiente.

### **Te ardhurat**

2,391,178 leke jane te ardhurat e realizuara per vitin 2020, shume e cila eshte me e larte se dy vitet parardhese viti 2018 dhe 2019. Ne vitin 2020 te ardhurat jane 71% me shume se ne vitin 2019.

**Table 3 Te ardhurat 2018 - 2020**



Buxheti i parashikuar per vitin **2021** eshte ne total **36,000,000 leke**, i ndare sipas zerave:

**Table 4 Plan buxheti 2021**

Nr.	EMERTIMI	Buxheti Plan	Realizimi ne %
1	Paga	15,000,000	42 %
2	Sigurime	3,000,000	8 %
3	Korrente	5,000,000	14 %
4	Kuotat nderk	9,000,000	25 %
5	Investime	4,000,000	11 %
	<b>SHUMA</b>	<b>36,000,000</b>	<b>100 %</b>